REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. 6189 Prot

Maliq, më 19.11.2025

PROJEKT VENDIM - Nr. 8

"PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË BASHKISË NR. 75 DATË 30.06.2025 "PËR NGRITJEN E BORDIT ARTISTIK TË BASHKISË MALIQ"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", të ndryshuar, Vendimit nr. 540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave "*Për krijimin e këshillave artistiko - kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre*", të ndryshuar, me vendimin nr.121 datë 25.02.2005, udhëzimit nr.1, datë 24.05.2005 të Ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve "*Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko - kulturor*", Vendimi i Këshillit të Bashkisë Maliq Nr.130, datë 26.12.2024 "*Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025*", si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 75 datë 30.06.2025 "*Për ngritjen e bordit artistik të Bashkisë Maliq*"

PROPOZOJ

1. Të ndryshohet pika 1 si më poshtë:
   - "*Të krijohet bordi artistik pranë Bashkisë Maliq të përbërë nga 5 anëtarë dhe kandidatët të jenë nga fusha e kulturës, artit, letërsisë, sportit dhe ekonomist*"

2. Të ndryshohet pika 2 si më poshtë:
   - " *Anëtarët e Bordit do të kenë një mandat 4-vjeçar me të drejtë ripërtëritje dhe do të ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me parashikimet e legjislacionit. Mandati i ndonjë anëtari mund të ndërpritet ose të zëvendësohet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, në rastet kur konstatohet pamundësi për ushtrimin e detyrës, shkelje të detyrimeve ligjore apo mungesë e vazhdueshme në veprimtaritë e Bordit dhe Anëtarët e bordit nuk duhet të jenë të punësuar në institucionet në varësi të bashkisë, pasi krijojnë konflikt interesi duke votuar për projektet e tyre* ".

3. Mbas pikë 4 të shtohet pika 5 me përmbajtje:
   - *"Pagesa e anëtarëve të Bordit të jetë 4500 (katër mijë e pesëqind) lekë në muaj, për ato muaj që do të zhvillohen mbledhje".*
   - *Të drejtën e shpërblimit e përfitojnë dhe personat që aktivizohen në këshilla të përkohshëm artistiko-kulturore, si juri ose komisione vlerësimi. Këta persona shpërblehen në masën 5000 (pesë mijë) lekë, për ato muaj që do të zhvillohen mbledhje".*

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Kulturës, pranë Agjencisë të Shërbimeve Mbështetëse në Bashki.

	(Emër Mbiemër)	Firma	Data
Konceptoi:	J. Thomo		19.11.2025
Drejtori i Drejtorisë	G. Floqi		19.11.2025

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu